



Plani i veprimit të menaxhmentit të AKK-së, për zbatimin e rekomandimeve nga
Raporti i Auditimit të ZKA-së, për pasqyrat financiare të përfunduara me 31 dhjetor 2019

Data: 11.08.2020.

Nr.	Çështja E gjetura Ndikimi Rekomandimi	Veprimi i menaxhmentit	Data e planifikuar e përfundimit	Personi përgjegjës
1.	<p>Çështja A1: Dobësi në menaxhimin e shpenzimeve të automjeteve</p> <p>E gjetura: Udhëzimi Administrativ për përdorimin e automjeteve zyrtare, obligon që drejtuesit e automjeteve zyrtare duhet të mbajnë evidenca të udhëtimeve dhe kopjet e faturave të furnizimeve të karburanteve, servisimit etj. Gjatë testimit të katër (4) pagesave për derivate në vlerë 1,438€, ne kemi vërejtur që prej 7 automjeteve, prej tyre 4 sish nuk mbajnë evidencë të librit të udhëtimeve dhe kilometrave të kaluara për të vërtetuar shpenzimet e ndodhura. Kjo ishte bërë si rezultat i kontrollit jo të mirë të këtyre shpenzimeve.</p> <p>Ndikimi: Mos mbajta e evidencës së librit të udhëtimeve dhe kilometrave mund të ndikojë në menaxhimin jo të mirë të shpenzimeve.</p> <p>Rekomandimi A1: Kryetari i AKK-së duhet të siguroj që për të gjitha automjetet që janë në shfrytëzim apo në pronësi të AKK-së, mbahen evidencat e udhëtimit dhe kilometrave për secilin udhëtim.</p>	Kryetari i AKK-së siguron që të gjitha automjetet që janë në pronësi dhe shfrytëzim të AKK-së, nga data 01.09.2020 nuk mund të shfrytëzohen pa mbajtjen e evidencës së udhëtimeve.	31.08.2020.	Drejtori i përgjithshëm i Sekretariatit të AKK-së.

